



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 14.02.2025

Nr: 91

Ora: 12: 00

VENDIM

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE BAZUAR NË
DENONCIMIN NR. 15, DATË 13.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE,
TË KOALICIONIT PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 14.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, pasi mori në shqyrtim paraprak denoncimin me:

KËRKUES: Koalicioni Për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/ KRIIK

SUBJEKT: Z. Gerti Janaqi
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit
Parauniversitar

Zj. Rezarta Alla
Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar

Z. Hasbi Lika
Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë

Zj. Zaira Gjika
Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier

Zj. Bora Sala
Drejtorja i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës

OBJEKT: Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit të sloganeve / hashtag-eve partiakë / elektorale



BAZA LIGJORE: Neni 91, pikat 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, dhe 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, neni 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 09.03.2021, të Komisionit Rregullator

KONSTATOJ:

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 13.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 15 ID.

Në këtë denoncim KRIIK parashtron sa vijon:

“Faqet Zyrtare në Facebook të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Arsimit dhe Sportit janë duke u përdorur sloganet elektorale të Partisë Socialiste.

Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në “Facebook” e Institucioneve të mëposhtme:

- 1. Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;*
- 2. Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar;*
- 3. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Tiranë;*
- 4. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier;*
- 5. Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Durrës-Zyrtare.”*

Nga sa më sipër çmoj se, ekzistojnë kushtet për t’u nisur hetimi administrativ.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe “n”, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 8, pika 3, të Vendimit nr. 9, datë 9.3.2021, të Komisionit Rregullator në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve,

VENDOS:

1. Fillimin e procedurës administrative ndaj:

- Z. Gerti Janaqi, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar;
- Zj. Rezarta Alla, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar;
- Z. Hasbi Lika, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Tiranë;
- Zj. Zaira Gjika, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier;
- Zj. Bora Sala, Drejtor i Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës.

2. Rezultatet e këtij Vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

